



HEMORAGJIA E ARSIMIT SHQIPTAR

RAPORT MONITORIMI

Qershor 2026



AUTOR
Vilson Blloshmi

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE	4
2.	METODOLOGJIA	5
3.	INSTITUCIONET DHE NXËNËSIT E ARSIMIT BAZË DHE TË MESËM	5
4.	NUMRI I KLASAVE KOLEKTIVE/TË BASHKUARA	8
5.	NUMRI I NXËNËSVE QË STUDIOJNË NË KLASA KOLEKTIVE	10
6.	NUMRI I SHKOLLAVE QË JANË MBYLLUR	11
7.	NUMRI I MËSUESVE DHE RAPORTET GJINORE TË NXËNËSVE	12
8.	RAPORTET GJINORE TË NXËNËSVE (2015–2025) INSTAT	12
9.	GJETJET KRYESORE	14
10.	REKOMANDIME	15

1. HYRJE

Ky raport paraqet një analizë të përditësuar të zhvillimeve në arsimin parauniversitar publik në Shqipëri gjatë periudhës 2014–2015 deri 2023–2024, me fokus te arsimit bazë dhe arsimi i mesëm.

Temat që lidhen me demografinë, arsimin apo edhe me kombinimin mes tyre nuk janë të rralla në hapësirën publike shqiptare. Megjithatë të ndarë në disa linja të ndryshme mendimi apo arsyetimi, askush nuk mund të mohojë rëndësinë jetike që ka arsimi në zhvillimin e një vendi. Megjithatë, vlerësimi i arsimit nuk është gjithmonë i lehtë, sidomos kur bëhet fjalë për cilësinë dhe ndikimin e tij real në shoqëri. Për këtë arsye, ky raport zgjedh të ndalet tek një dimension shpesh i nënvlerësuar, por thelbësor, faktori demografik.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të rëndësishme demografike. Tkurja e popullsisë, ulja e lindshmërisë dhe nivelet e larta të emigracionit, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, kanë ndikuar drejtpërdrejt në shumë sektorë, ndër të cilët arsimi zë një vend të veçantë. Këto zhvillime nuk janë vetëm shifra statistikore, por realitete që reflektohen në klasat e shkollave, në numrin e nxënësve dhe në funksionimin e institucioneve arsimore.

Duke u nisur nga ky kontekst, ky raport synon të analizojë lidhjen mes ndryshimeve demografike dhe zhvillimeve në arsimin parauniversitar në Shqipëri, me fokus të veçantë tek arsimi bazë, i mesëm i ulët dhe ai i mesëm i lartë. Përmes të dhënave dhe fakteve, synohet të ofrohet një pasqyrë më e qartë mbi mënyrën se si faktorë si emigracioni dhe lindshmëria kanë ndikuar në sistemin arsimor gjatë viteve të fundit.

Në mënyrë më konkrete, raporti do të trajtojë disa tregues kyç për periudhën 2015–2025. Këtu do të përfshijmë numrin e nxënësve sipas niveleve të arsimit, përhapjen e klasave kolektive dhe numrin e nxënësve që ndjekin mësimin në to, si dhe numrin e shkollave aktive sipas kategorive të ndryshme. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe shkollave të mbyllura gjatë kësaj periudhe, shpërndarjes së tyre gjeografike dhe lidhjes me njësitë vendore arsimore. Gjithashtu, raporti do të analizojë raportin gjinor të nxënësve ndër vite.

Përmes kësaj qasjeje, synohet jo vetëm të paraqiten të dhënat, por edhe të kuptohet më mirë se çfarë tregojnë ato për të ardhmen e arsimit në Shqipëri dhe për sfidat që lidhen me ndryshimet demografike në vend.

2. METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në një qasje sasiore, e cila synon të analizojë në mënyrë të strukturuar dhe të matshme ndikimin e faktorëve demografikë në arsimin parauniversitar në Shqipëri. Përzgjedhja e kësaj metodologjie lidhet me nevojën për të përdorur të dhëna konkrete dhe të verifikueshme, që mundësojnë krahasime ndër vite dhe identifikimin e trendeve kryesore.

Të dhënat e përdorura në këtë raport janë mbledhur përmes dy burimeve kryesore. Së pari, është përdorur kërkesa për informacion si instrument kërkimor, përmes së cilës janë siguruar të dhëna zyrtare nga institucionet përgjegjëse për arsimin. Kjo ka bërë të mundur mbledhjen e informacionit të detajuar mbi numrin e nxënësve, klasat kolektive, shkollat aktive dhe ato të mbyllura, si dhe numrin e mësuesve për periudhën 2015–2026.

Së dyti, janë përdorur të dhëna të agreguara nga INSTAT si dhe të dhënat statistikore të Ministrisë së Arsimit, të cilat kanë shërbyer për të analizuar treguesit demografikë si lindshmëria, migracioni dhe ndryshimet në popullsi. Këto të dhëna kanë ndihmuar në krijimin e një kuadri më të gjerë analitik, duke lidhur zhvillimet demografike me ndryshimet në sistemin arsimor.

3. INSTITUCIONET DHE NXËNËSIT E ARSIMIT BAZË DHE TË MESËM

Gjatë periudhës 2014–2015 deri në vitin shkollor 2023–2024, sistemi i arsimit parauniversitar publik në Shqipëri ka kaluar nëpër një proces të vazhdueshëm tkurrjeje, i reflektuar qartë si në numrin e nxënësve, ashtu edhe në numrin e institucioneve arsimore. Të dhënat¹ tregojnë se kjo rënie ka prekur si arsimin bazë, ashtu edhe arsimin e mesëm të lartë,

Në arsimin bazë, rënia e numrit të nxënësve është e ndjeshme dhe e vazhdueshme përgjatë gjithë dekadës. Në vitin 2014–2015, në shkollat publike të arsimit bazë ishin të regjistruar 342,765 nxënës. Deri në vitin 2023–2024, ky numër ka rënë në 228,833 nxënës. Pra, brenda dhjetë viteve, sistemi ka humbur 113,932 nxënës, ose rreth një të tretën e totalit fillestar. Kjo rënie nuk është episodike, por lineare dhe pothuajse e pandërprerë nga viti në vit. Vetëm nga 2014–2015 në 2015–2016 ka një

¹ Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1 - 5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6 - 9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç. Arsimi i mesëm i lartë përfshin gjimnazin, arsimin social-kulturor dhe arsimin profesional.

rënie prej mbi 20 mijë nxënësish, ndërsa trendi vazhdon me ritme të ngjashme në vitet pasuese.

Kjo tendencë tregon qartë se numri i fëmijëve në moshën e detyrueshme shkollore në Shqipëri është zvogëluar ndjeshëm. Faktorët kryesorë lidhen me uljen e lindshmërisë, emigracionin e familjeve të reja dhe zhvendosjen e popullsisë nga zonat rurale drejt qendrave urbane ose jashtë vendit. Në shumë zona periferike dhe rurale, numri i fëmijëve është bërë i pamjaftueshëm për të mbajtur të njëjtin kapacitet shkollor si më parë.

Tabela 1. Vjetari Statistikor për Arsimin në 10 vitet e fundit

Viti	Nxënës Arsimi Bazë	Nxënës Arsimi i Mesëm i Lartë
2014-2015	342,765	125,517
2015-2016	322,367	116,987
2016-2017	305,287	112,903
2017-2018	296,736	87,211
2018-2019	282,906	82,845
2019-2020	270,113	77,382
2020-2021	261,780	76,848
2021-2022	251,207	73,042
2022-2023	238,997	66,999
2023-2024	228,833	63,092

Burimi: Ministria e Arsimit²

Edhe më dramatike paraqitet situata në arsimin e mesëm. Në vitin 2014–2015, në institucionet publike të arsimit të mesëm ishin të regjistruar 125,517 nxënës. Në vitin 2023–2024 ky numër zbrit në vetëm 63,092 nxënës. Kjo do të thotë se brenda dekadës është përgjysmuar numri i nxënësve, me një humbje totale prej 62,425 nxënësish. Rënia prej rreth 50 për qind është shumë domethënëse dhe sinjalizon se sistemi i arsimit të mesëm po përballet me sfida edhe më të thella sesa arsimit bazë.

Kjo rënie është pasojë e një efekti domino që pasohet nga ulja e numrit të nxënësve në arsimin 9 vjeçar. Gjithashtu, një pjesë e të rinjve emigrojnë me familjet e tyre para mbarimit të arsimit bazë, ndërsa të tjerë zgjedhin alternativa të tjera si arsimit profesional, puna informale

² <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Vjetari-Statistikor-per-Arsimin-2023-2024.pdf>


apo migrimi i hershëm. Kjo e bën tkurrjen e arsimit të mesëm edhe më të theksuar.

Ky fenomen mund të shpjegohet me faktin se shkollat e mesme zakonisht mbulojnë zona më të gjera dhe përqendrohen në qytete apo qendra administrative, duke qenë më të vështira për t'u mbyllur ose bashkuar. Megjithatë, kjo situatë sjell një tjetër pasojë: shumë shkolla të mesme funksionojnë sot me më pak nxënës se më parë, çka mund të rrisë kostot për nxënës dhe të krijojë nevojë për rishikim të modelit të financimit.

Numri i lindjeve në Shqipëri ka shënuar një rënie të vazhdueshme gjatë periudhës 2014–2025. Nga 35,717 lindje në vitin 2014, numri ra në 22,541 në vitin 2025, duke përfaqësuar një ulje prej 13,176 lindjesh ose rreth 36,9%. Rënia ka qenë e pandërprerë nga një vit në tjetrin, pa asnjë periudhë rikuperimi. Uljet më të mëdha vërehen në vitet 2014–2015 (-3,045 lindje), 2017–2018 (-1,930 lindje) dhe veçanërisht 2021–2022 (-2,523 lindje), ndërsa gjatë viteve 2023–2025 ritmi i rënies është ngadalësuar, por trendi mbetet negativ.

Ky zhvillim pasqyron sfidat demografike me të cilat përballet vendi, të lidhura me emigracionin e popullsisë në moshë riprodhuese, rritjen e normës së fertilitetit, shtyrjen e lindjes së fëmijëve në moshë më të vonshme dhe plakjen e popullsisë. Rënia e vazhdueshme e lindjeve pritet të ndikojë drejtpërdrejt në numrin e fëmijëve që hyjnë në sistemin arsimor, duke sjellë tkurrje të popullsisë shkollë, si dhe në perspektivën afatgjatë të tregut të punës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të mbrojtjes sociale. Kjo nënvizon nevojën për politika të integruara që mbështesin familjet e reja dhe adresojnë sfidat demografike të vendit.

Grafiku 1. Numri i lindjeve në harkun kohor të viteve 2014-2025



Burimi: INSTAT

Nëse krahasojmë numrin mesatar të nxënësve për institucion, tabloja bëhet edhe më e qartë. Në arsimin bazë, në vitin 2014–2015 kishte mesatarisht rreth 260 nxënës për institucion, ndërsa në vitin 2023–2024 kjo mesatare bie në rreth 226 nxënës. Në arsimin e mesëm, rënia është edhe më e fortë: nga rreth 329 nxënës për institucion në vitin 2014–2015, në vetëm rreth 180 nxënës për institucion në vitin 2023–2024. Kjo tregon se shumë institucione funksionojnë me kapacitete të reduktuara.

Të dhënat e dekadës së fundit tregojnë se arsimi publik në Shqipëri po përballet me një turrje të thellë dhe afatgjatë. Arsimi bazë ka humbur një të tretën e nxënësve dhe gati një të katërtën e institucioneve, ndërsa arsimi i mesëm ka humbur gjysmën e nxënësve dhe një pjesë më të vogël të institucioneve. Këto zhvillime nuk janë vetëm çështje statistikore, por pasqyrojnë ndryshime të rëndësishme në strukturën demografike dhe sociale të vendit. Nëse këto trende vazhdojnë, politikat arsimore do të duhet të fokusohen jo vetëm në administrimin e rënies numerike, por mbi të gjitha në garantimin e cilësisë, aksesit të barabartë dhe qëndrueshmërisë së sistemit arsimor publik në të ardhmen.

4. NUMRI I KLASAVE KOLEKTIVE/TË BASHKUARA

Klasat kolektive vazhdojnë të mbeten një shqetësim i madh i cili është i adresuar dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Ky objektivi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit thekson rëndësinë e racionalizimit të rrjetit të shkollave si përgjigje ndaj ndryshimeve demografike dhe rënies së numrit të nxënësve. Në qendër të tij qëndron pakësimi i numrit të nxënësve që ndjekin mësimin në klasa kolektive, përmes transferimit të tyre në shkolla ku mund të zhvillojnë procesin mësimor në klasa normale me bashkëmoshatarët. Zbatimi i këtij objektivi mbështetet në projeksionet demografike dhe në garantimin e transportit shkollor, duke synuar një organizim më efikas të rrjetit arsimor dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Njëkohësisht, strategjia parashikon bashkëpunim të ngushtë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, prindërit dhe organizatat e shoqërisë civile për të lehtësuar këtë proces dhe për të siguruar pranueshmërinë e ndryshimeve nga komuniteti. Ky objektivi lidhet ngushtë me tendencat e konsolidimit të rrjetit të shkollave, të cilat pasqyrohen edhe në të dhënat e analizuara në këtë raport.

Tabela 2. Numri i klasave kolektive/bashkuara sipas viteve 2015-2016

Viti shkollor	Klasa kolektive/të bashkuara
2015-2016	3,241
2016-2017	3,290
2017-2018	3,210
2018-2019	2,685
2019-2020	2,618
2020-2021	2,517
2021-2022	2,558
2022-2023	2,445
2023-2024	2,369
2024-2025	2,320
2025-2026	2,253

Burimi: Kthim përgjigje Organizatës "Qëndresa Qytetare", 21 prill 2026, Ministria e Arsimit

Numri i klasave kolektive/bashkuara ka rënë nga 3,241 në vitin shkollor 2015–2016 në 2,253 në vitin 2025–2026. Kjo përfaqëson një ulje me afro 30.5% gjatë një dekade. Rënia nuk ka qenë lineare, por më e theksuar pas vitit 2018. Nga 3,210 klasa në vitin 2017–2018, numri zbret në 2,685 në vitin 2018–2019, pra një reduktim i menjëhershëm me mbi 500 klasa brenda një viti. Kjo tregon ndërhyrje strukturore në sistemin arsimor, si bashkime shkollash, mbyllje institucionesh me numër të ulët nxënësish, ose regjistrim të nxënësve drejt shkollave më të mëdha.

Ndonëse numri i klasave kolektive ka pësuar rënie dhe ky trend vazhdon, vendi është ende larg objektivit për eliminimin e tyre, siç parashikohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit.

Për më tepër, duke qenë se klasat kolektive mbeten një realitet i qëndrueshëm në shumë zona të vendit, mungon ende një sistem i mirëfilltë trajnimi dhe profilizimi i mësuesve për të punuar në këto klasa. Mësimdhënia në klasa kolektive kërkon kompetenca dhe metodologji specifike, pasi një mësues duhet të zhvillojë njëkohësisht procesin mësimor për nxënës të grupmoshave dhe niveleve të ndryshme.

5. NUMRI I NXËNËSVE QË STUDIOJNË NË KLASA KOLEKTIVE

Njëkohësisht, numri i nxënësve që ndjekin mësimin në klasa kolektive ka rënë edhe më ndjeshëm. Në vitin 2015–2016 ishin 35,843 nxënës, ndërsa në vitin 2025–2026 rezultojnë 17,864 nxënës. Pra kemi pothuajse përgjysmim të numrit të nxënësve (-50.2%) në vetëm dhjetë vite. Kjo rënie është më e fortë se ajo e vetëm numrit të klasave, ç'ka nënkupton se jo vetëm janë pakësuar klasat kolektive, por edhe madhësia mesatare e tyre është zvogëluar.

Nëse krahasojmë raportin nxënës për klasë kolektive, në vitin 2015–2016 rezultojnë rreth 11 nxënës për klasë, ndërsa në vitin 2025–2026 rreth 8 nxënës për klasë. Kjo tregon se në zonat ku këto klasa vazhdojnë të ekzistojnë, popullsia shkollore është bërë më e rrallë dhe shpesh shkollat mbeten me numër minimal nxënësish.

Të dhënat tregojnë një rënie të përgjithshme të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet arsimore gjatë viteve të fundit, e shoqëruar me një ulje të numrit të klasave dhe një luhajtje në organizimin e klasave kolektive.

Të dhënat paraqesin një panoramë të qartë të transformimeve që ka kaluar arsimi bazë publik në Shqipëri gjatë periudhës 2015–2026, veçanërisht në lidhje me funksionimin e klasave kolektive/bashkuara dhe me shpërndarjen e nxënësve sipas klasave. Në tërësi, vihet re një trend i fortë rënës si në numrin e klasave kolektive, ashtu edhe në numrin e nxënësve që studiojnë në to, ç'ka lidhet ngushtë me ndryshimet demografike, migracionin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe riorganizimin e rrjetit shkollor.

Tabela 3. Numri i nxënësve që studiojnë në klasa kolektive 2015-2026 në arsimin bazë publik

Viti shkollor	Nxënës në klasa kolektive/bashkuara
2015-2016	35,843
2016-2017	35,950
2017-2018	33,941
2018-2019	25,863
2019-2020	23,118
2020-2021	21,494
2021-2022	22,029
2022-2023	20,779
2023-2024	19,201
2024-2025	18,641
2025-2026	17,864

Burimi: Kthim përgjigje Organizatës "Qëndresa Qytetare", 21 prill 2026, Ministria e Arsimit

6. NUMRI I SHKOLLAVE QË JANË MBYLLUR

Paralelisht me rënien e numrit të nxënësve, është reduktuar edhe numri i institucioneve të arsimit bazë. Në vitin 2014–2015 funksiononin 1,317 institucione të arsimit bazë publik, ndërsa në vitin 2023–2024 ky numër zbrit në 1,014 institucione. Kjo përfaqëson një ulje prej 303 institucionesh, ose rreth 23 për qind. Kjo është një rënie e konsiderueshme dhe tregon se shteti është detyruar të riorganizojë rrjetin shkollor për shkak të mungesës së nxënësve në shumë zona.

Në praktikë, kjo do të thotë bashkim shkollash, mbyllje të shkollave me pak nxënës, transformim të disa shkollave në klasa kolektive apo transport të nxënësve drejt qendrave më të mëdha. Në zonat urbane kjo mund të jetë menaxhuar më lehtë, por në zonat malore dhe të largëta ka sjellë sfida të mëdha për aksesin në arsim.

Ndryshe nga arsimit bazë, institucionet e arsimit të mesëm kanë shfaqur një qëndrueshmëri më të madhe numerike. Në vitin 2014–2015 ishin 381 institucione të arsimit të mesëm publik, ndërsa në vitin 2023–2024 rezultojnë 351 institucione. Pra, rënia është vetëm 30 institucione, ose rreth 8 për qind. Kjo tregon se megjithëse numri i nxënësve është përgjysmuar, infrastruktura institucionale e arsimit të mesëm nuk është tkurrur në të njëjtën masë.

Ky fenomen mund të shpjegohet me faktin se shkollat e mesme zakonisht mbulojnë zona më të gjera dhe përqendrohen në qytete apo qendra administrative, duke qenë më të vështira për t'u mbyllur ose bashkuar. Megjithatë, kjo situatë sjell një tjetër pasojë: shumë shkolla të mesme funksionojnë sot me më pak nxënës se më parë, çka mund të rrisë kostot për nxënës dhe të krijojë nevojë për rishikim të modelit të financimit.

Nëse krahasojmë numrin mesatar të nxënësve për institucion, tabloja bëhet edhe më e qartë. Në arsimin bazë, në vitin 2014–2015 kishte mesatarisht rreth 260 nxënës për institucion, ndërsa në vitin 2023–2024 kjo mesatare bie në rreth 226 nxënës. Në arsimin e mesëm, rënia është edhe më e fortë: nga rreth 329 nxënës për institucion në vitin 2014–2015, në vetëm rreth 180 nxënës për institucion në vitin 2023–2024. Kjo tregon se shumë institucione funksionojnë me kapacitete të reduktuara.

7. NUMRI I MËSUESVE DHE RAPORTET GJINORE TË NXËNËSVE

Tabela 4. Vjetari Statistikor për Arsimin në 10 vitet e fundit

Viti	Institucione Arsimit Bazë	Institucione Arsimit Mesëm
2014-2015	1,317	381
2015-2016	1,284	381
2016-2017	1,249	380
2017-2018	1,220	380
2018-2019	1,144	349
2019-2020	1,109	346
2020-2021	1,057	346
2021-2022	1,051	347
2022-2023	1,029	349
2023-2024	1,014	351

Burimi: Ministria e Arsimit³

8. RAPORTET GJINORE TË NXËNËSVE (2015–2025) INSTAT

Të dhënat tregojnë një rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve të regjistruar si në gjimnaze ashtu edhe në shkolla profesionale gjatë periudhës 2015–2025. Megjithatë, raporti gjinor paraqet karakteristika të ndryshme sipas llojit të arsimit.

Në gjimnaze, numri total i nxënësve ka rënë nga 104,952 në vitin 2015 në 69,111 në vitin 2025, që përfaqëson një ulje prej rreth 34%. Gjatë gjithë periudhës, vajzat përbëjnë shumicën e nxënësve të regjistruar. Në vitin 2015, vajzat përfaqësonin rreth 53.4% të të gjithë nxënësve të gjimnazit (56,002 vajza kundrejt 48,950 djemve). Në vitin 2025, ky raport mbetet pothuajse i pandryshuar, me 37,651 vajza dhe 31,460 djem, ose rreth 54.5% vajza dhe 45.5% djem. ⁴Kjo tregon se, pavarësisht rënies së numrit të përgjithshëm të nxënësve, vajzat vazhdojnë të jenë më të pranishme në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

³ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Vjetari-Statistikor-per-Arsimin-2023-2024.pdf>

⁴ https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_ED_REG/ArSm01/table/tableViewLayout1/

Tabela 5. Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar

Viti	Gjithsej	Femra	Meshkuj
2015	343,499	162,208	181,291
2016	328,100	154,878	173,222
2017	319,671	151,488	168,183
2018	306,530	145,063	161,467
2019	294,879	139,935	154,944
2020	286,486	136,219	150,267
2021	278,138	132,547	145,591
2022	267,275	127,641	139,634
2023	258,072	123,745	134,327
2024	250,617	120,247	130,370
2025	243,764	117,019	126,745

Burimi: INSTAT

Të dhënat tregojnë një rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin 9-vjeçar gjatë periudhës 2015–2025. Numri i përgjithshëm i nxënësve ka rënë nga 343.499 në 243.764, ose me 99.735 nxënës (-29,0%). Rënia është e pandërprerë përgjatë gjithë periudhës dhe lidhet kryesisht me tkurrjen demografike, uljen e lindjeve dhe emigracionin e familjeve me fëmijë.

Sipas gjinisë, si numri i meshkujve ashtu edhe i femrave ka shënuar rënie. Numri i meshkujve ka zbritur nga 181.291 në 126.745 (-54.546 ose -30,1%), ndërsa numri i femrave nga 162.208 në 117.019 (-45.189 ose -27,9%). Gjatë gjithë periudhës, meshkujt përbëjnë një pjesë pak më të madhe të popullsisë shkollore, rreth 52%, ndërsa femrat rreth 48%, raport që mbetet pothuajse i pandryshuar.

Në ciklin e ulët, numri i nxënësve është ulur nga 179.564 në 132.018 (-26,5%), ndërsa në ciklin e lartë rënia është më e theksuar, nga 163.935 në 111.746 (-31,8%). Kjo tregon se tkurrja e popullsisë shkollore është ndjerë më fort në klasat VI–IX, si rezultat i brezave me më pak lindje që kanë hyrë gradualisht në sistemin arsimor.

Në tërësi, të dhënat konfirmojnë se arsimi 9-vjeçar në Shqipëri po përballlet me një tkurrje të vazhdueshme të numrit të nxënësve. Ky trend pritet të ndikojë në planifikimin e rrjetit të shkollave, organizimin e klasave, shpërndarjen e mësuesve dhe investimet në infrastrukturën arsimore, duke kërkuar politika të bazuara në projeksionet demografike dhe nevojat reale të sistemit arsimor.

Tabela 6. Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm

Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm											
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Meshkuj	48,950	47,503	44,287	42,185	40,308	39,890	38,542	35,096	33,460	31,640	31,460
Femra	56,002	54,492	51,019	49,266	46,542	46,292	43,825	41,558	39,428	38,130	37,651
Gjithsej	104,952	101,995	95,306	91,451	86,850	86,186	82,367	76,654	72,888	69,770	69,111

Burimi: INSTAT

9. GJETJET KRYESORE

1. Rrjeti i institucioneve të arsimit bazë u tkurr me 23% në 10 vitet e fundit, nga 1,317 në 1,014 institucione, kryesisht si pasojë e rënies së numrit të nxënësve, emigracionit dhe ndryshimeve demografike, me ndikim më të madh në zonat rurale.
2. Institucionet e arsimit të mesëm u reduktuan me 8% në 10 vitet e fundit, nga 381 në 351, duke reflektuar një tkurrje më të moderuar të rrjetit shkollor në këtë nivel.
3. Numri i nxënësve në arsimin bazë ra me 33% në 10 vitet e fundit, nga 342,765 në 228,833, duke konfirmuar ndikimin afatgjatë të rënies së lindshmërisë dhe emigracionit mbi popullsinë shkollore.
4. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm u përgjysmua (-50%) në 10 vitet e fundit, nga 125,517 në 63,092, duke evidentuar një tkurrje më të theksuar se në arsimin bazë.
5. Lindjet ranë me 37% gjatë periudhës 2014–2025, nga 35,717 në 22,541, duke sinjalizuar se rënia e popullsisë shkollore do të vijojë edhe në vitet e ardhshme.
6. Numri i klasave kolektive u ul me 30.5% në harkun kohor 2015-2026, nga 3,241 në 2,253, megjithëse ato mbeten një realitet në zonat rurale dhe të thella.
7. Numri i nxënësve në klasa kolektive u reduktua me 50.2% në harkun kohor 2015-2026, nga 35,843 në 17,864, çka tregon se tkurrja e popullsisë shkollore në këto zona është më e shpejtë se reduktimi i vetë klasave.
8. Raporti gjinor i nxënësve mbetet i qëndrueshëm. Në arsimin bazë djemtë përbëjnë rreth 52% të nxënësve dhe vajzat 48%, ndërsa në arsimin e mesëm të përgjithshëm dominojnë vajzat.

10. REKOMANDIME

1. Hartimi i një strategjie afatgjatë për përshtatjen e sistemit arsimor me ndryshimet demografike.

Politikat arsimore duhet të bazohen në projeksione demografike afatgjata, duke planifikuar rrjetin e shkollave, nevojat për mësues dhe investimet në infrastrukturë në përputhje me tendencat e popullsisë.

2. Ulja graduale e klasave kolektive.

Ministria e Arsimit duhet të vazhdojë zbatimin e objektivit për reduktimin e klasave kolektive, duke investuar në transportin e nxënësve dhe në përmirësimin e kushteve në shkollat pritëse.

3. Rishikimi i modelit të financimit të shkollave.

Financimi i institucioneve arsimore duhet të marrë në konsideratë jo vetëm numrin e nxënësve, por edhe faktorë si largësia gjeografike, izolimi, funksioni social i shkollës dhe nevoja për garantimin e aksesit universal në arsim.

4. Hartimi i një politike të posaçme për zonat rurale.

Në zonat ku mbyllja e shkollave nuk është zgjidhje e përshtatshme, duhet të zhvillohen modele alternative të organizimit të mësimin, përdorimi i teknologjisë dhe mbështetje shtesë për mësuesit.

5. Hartimi i politikave ndërsektorale për adresimin e sfidave demografike.

Rënia e popullsisë shkollore nuk mund të trajtohet vetëm përmes politikave arsimore. Kërkohet koordinim ndërmjet politikave të arsimit, zhvillimit ekonomik, mbështetjes së familjeve të reja, strehimit dhe migracionit.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al